

INDEKSI I ÇMIMEVE TË PRODHIMIT

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

Metadata Referenciale	1
1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	5
5. Periudha e referencës	5
6. Mandati institucional	5
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	7
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	7
11. Manaxhimi i cilësisë	8
12. Rëndësia.....	9
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	9
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	10
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	10
16. Kostoja dhe ngarkesa	11
17. Rishikimi i të dhënave	11
18. Përpunimi statistikor	12
19. Komente.....	13
Aneks	13

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Spektori i Çmimeve, Drejtoria e Statistikave Sektoriale
1.3. Personi i kontaktit	Rovena Gjyshi
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Spektori Çmimeve
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	rgjyshi@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	05.03.2024
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	05.03.2024
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	05.03.2024
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) është një nga treguesit kryesorë afatshkurtër të biznesit; konsiderohet si një nga matësit e rëndësishëm të situatës ekonomike në vend. Indeksi i Çmimeve të Prodhimit mat ecurinë e çmimeve të prodhimit të produkteve industriale të prodhuara me destiancion tregun vendas dhe eksport. Ky indeks përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Indeksi Gjithsej i Çmimeve të Prodhimit; • Indeksi i Çmimeve të Prodhimit në Industri për tregun vendas, i

	<p>cili mat ecurinë e çmimeve të prodhimit të produkteve industriale të prodhuara dhe shitur në tregun vendas;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Indeksi i Çmimeve të Eksportit, i cili mat ecurinë e çmimeve (të konvertuara në monedhën vendase përfshirë kursin e këmbimit) të produkteve industriale të prodhuara në vend dhe me destinacion shitjeje tregun e huaj.
3.2. Sistemi i klasifikimit	<p>Klasifikimi i përdorur për Indeks të Prodhimit të Prodhimit është Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev.2 (NVE Rev.2). Të dhënat prodhohen në nivel kombëtar, të grupuar në nivel dy shifror sipas aktivitetit ekonomik të kësaj nomenklature. Deri në tremujorin e dytë 2014, të dhënat janë prodhuar duke përdorur NVE Rev.1.1. Duke filluar nga tremujori i dytë 2014, të dhënat publikohen në NVE Rev.2.</p>
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Indeksit i Çmimeve të Prodhimit mbulon këto aktivitete ekonomike:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Industri nxjerrëse – B: 05–09 • Industri përpunuese – C: 10–34 • Energji elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar – D: 35 • Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, E: 36- 38. <p>Mbledhja e të dhënave bëhet sipas rregullores 1165/98, e cila është miratuar në vitin 1998 dhe është ndryshuar në vitin 2005 në rregulloren 1185/2005 1999 – 2014, Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE) Rev.1.1.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Minierat dhe guoret – C: 10 – 14 • Prodhimi – D: 15 – 36 • Energjia elektrike, gazi, furnizimi me ujë - E: 40 – 41 2015 <p>Klasifikimi i Produkteve sipas Aktivitetit Ekonomik (KP), 1996 – 2002.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Industri nxjerrëse – B: 05 – 09 • Industri përpunuese – C: 10 – 34 • Energji elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar – D: 35 • Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, E: 36- 38.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Indeksi i Çmimeve të Prodhimit mat ndryshimin e çmimeve të prodhimit të produkteve që prodhohen në Shqipëri dhe që shiten nga prodhuesit në tregun e brendshëm (shqiptar) dhe/ose në tregun e jashtëm. Çmimi është e ardhura neto që fiton ndërmarrja prodhuese nga blerësi i një produkti të transportuar nën termat e caktuara të shitjes.</p> <p>Çmimi relativ është indeksi më i thjeshtë i ndryshimit të çmimit në përqindje të një produkti në dy periudha kohe të dhënë ku njëra prej tyre</p>

	<p>përbën periudhën bazë.</p> <p>Peshimi: Mesatarja e peshuar aritmetike e indekseve elementare të produkteve individuale formon indeksin. Indeksi në (short - term - link) për nivelin 6 shifror sipas NVE është llogaritur duke shumëzuar çdo peshë të produktit në nivel 6 shifror me çmimin relativ korrespondues dhe duke pjesëtuar shumën e tyre me shumën e peshave.</p> <p>Imputimi: Imputimet bëhen duke shumëzuar çmimin e periudhës së mëparshme me ndryshimin mesatar të çmimeve të produkteve të grupit në të cilin bën pjesë produktit (në nivelin më të ulët të agregimit 6 ose 2 shifror).</p> <p>Matësit e Indeksit:</p> <p>Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korrente në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet nga efektet e papërsëritshme të cilitdo tremujor.</p> <p>Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit midis dy tremujorëve më të fundit. Megjithëse korrent, ai mund të ndikohet nga efekte sezonale dhe efekte të tjera.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore për llogaritjen e Çmimeve të Prodhimit është ndërmarrja e prodhimit me aktivitet kryesor të përfshirë në fushën e mbulimit të indeksit sipas NVE Rev.2.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore për Indeksin e Çmimeve të Prodhimit janë të gjithë ndërmarrjet aktive në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Seksionet: B, C, D, E sipas NVE Rev.2.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit përfshijnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	<ul style="list-style-type: none"> • Seritë kohore të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit: 1999 – 2005 sipas NVE Rev 1.1. • Seri Kohore 2005 - 2014, NVE Rev.1 dhe NVE Rev.2. (2005 = 100, 2010 = 100) • Indekset e Çmimeve të Prodhimit për Tregun Vendas dhe Eksport 2007 - 2023.
3.9. Periudha bazë	Periudha bazë për Indeksin e Çmimeve të Prodhimit është viti 2020 = 100.

4. Njësia matëse	<p>Njësiti matëse janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Indekset; • Ndryshim tremujor në përqindje; • Ndryshim vjetor në përqindje.
5. Periudha e referencës	<p>Frekuencë tremujore me periudhë reference mujore. Ky raport i përket vitit referencë 2023.</p>
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore për indikatorët e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”; • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare, 2022-2026; • Rregullorja e Këshillit Evropian Nr.1165/98, “Mbi treguesit Afatashkurtër”; • Rregullorja e Komisionit Evropian Nr.1503/2006 përcaktimin e variablave dhe shpeshtësinë e përpilimit të të dhënave, shfuqizimin e porosive të reja të marra për ndërtimin e ndërtesave dhe porosinë e reja të marra për inxhinierinë civile; • Manuali i Statistikave Afatshkurtra: Manuali për prodhimin e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit: Teoria dhe praktika 2004.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	<p>Statistikat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit transmetohen në EUROSTAT. Aktualisht INSTAT plotëson një sërë pyetësorësh të organizmave ndërkombëtare në lidhje me rezultatet e vrojtimit të çmimeve të prodhimit, si Komisioni Evropian, Enterprise and Industry Directorate-General, OECD, etj.</p>
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit “Për statistikat zyrtare” përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësine burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e</p>

	<p>subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
<p>7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave</p>	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësive statistikore, shpërndahen nga Institute i Statistikave vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor;</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësive statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<p>8. Politika e botimit</p>	
<p>8.1. Kalendarin e publikimeve</p>	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
<p>8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve</p>	<p>Kalendarin e publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.</p>
<p>8.3. Aksesin i përdoruesve</p>	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, statistikat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e</p>

	<p>mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Website – online release; • Kërkesat e shkruara; • Publikimi; • Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	Shpeshtësia e shpërndarjes të të dhënave të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit është çdo tremujor.
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Sipas Kalendarit të publikimeve, çdo tremujor publikohet njoftim për media mbi Indeksin e Çmimeve të Prodhimit. Formatit i njoftimit për shtyp është përcaktuar nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i Indeksit të Çmimeve të Prodhimit publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Të gjitha të dhënat për Indeksin e Çmimeve të Prodhimit, përdoruesit mund ti gjejnë në faqen e internetit të INSTAT: <ul style="list-style-type: none"> • Shifrat; • Publikimi i dedikuar.
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit nga viti 1999 si viti referencë. Një shpjegim i thjeshtë metodologjik ekziston gjithashtu në faqen e internetit. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: Databaza
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	Të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 ligji nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një

	sesioni të dedikuar për kontaktet në linkun më poshtë: Kërkesë të dhënash.
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodogjinë mbi vrojtimin e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Çmimeve dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për statistikave zyrtare”, Nr.17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij. INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Kontrollet e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë tërë procesit dhe më pas analizohen nga stafi me qëllim përmirësimin e cilësisë së statistikave. Stafi ka përvojën e duhur për përlogaritjen e indeksit dhe është i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit të tij, të tilla si: mbledhja e të dhënave, kontrollet fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollet përfundimtare. Sektori kontrollon çmimet e çdo muaji. Nëse vërehet ndonjë çmim që ka lëvizje të madhe krahasuar me muajin e mëparshëm komunikohet me anketuesin. Nëse marrim një shpjegim justifikues për këtë ndryshim, çmimi përfshihet në llogaritje. Përndryshe anketuesi duhet të verifikojë përsëri çmimin e mbledhur në terren.

12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë: • Institucione të administratës publike; • Universitetet; • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare; • Bizneset; • Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. <p>Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin rezultatet e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit si input në punën e tyre, të cilët janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Llogarive Kombëtare; • Sektori i Statistikave Afatshkurtra.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet në lidhje me “Indeksin e Çmimeve të Prodhimit” për vitin 2023 janë 11,779.</p> <p>INSTAT kryen çdo vit vrojtimin për matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p> <p>Rezultatet e vrojtimit për 2023 tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës "Indeksi i Çmimeve të Prodhimit" është vlerësuar me 3.86 (ose 77.2%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Statistikat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit janë ndërtuar në përputhshmëri me rregulloren e Eurostatit në numër variablash, niveli i plotshmërisë të treguesve të prodhuar është 100%. Kjo përlllogaritje ka marrë në konsideratë rregulloren evropiane në nivel variablash.</p>
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Saktësia e përgjithshme e të dhënave të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit konsiderohet të jetë e lartë veçanërisht në saktësinë metodologjike të burimit të peshave dhe çmimeve dhe llogaritjes në përputhje me Rregulloren Evropiane.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Nuk është e aplikueshme për aktivitetin statistikor, pasi të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit janë të bazuara në kampione jo-probabilitare.</p>

<p>13.3. Gabim jo i kampionimit</p>	<p>Gabimet jo të kampionimit janë kryesisht gabime që ndodhin gjatë matjeve ose refuzimeve. Këto gabime vlerësohen dhe krahasohen me rezultatet e periudhave të mëparshme. Për të marrë informacionin korrekt dhe për të rritur normën e përgjigjeve, ndërmarrjet rikontaktohen me telefon ose drejtpërdrejt.</p> <p>Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën. Shkalla e mospërgjigjes në nivel rekordi për Indeksin e Çmimeve të Prodhimit 2023 është 7.27%.</p> <p>Mbi-mbulimi ndodh kur ndërmarrja e zgjedhur është në një aktivitet të caktuar objekt i anketimit dhe gjatë procesit të intervistimit ajo nuk është më objekt i anketimit ose statusi i ndërmarrjes ka ndryshuar, nuk është më aktive. Shkalla e mbi-mbulimit për Indeksin e Çmimeve të Prodhimit 2023 është 4.12%.</p>								
<p>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</p>									
<p>14.1. Afatet kohore</p>	<p>Rezultatet e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 65 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T+65 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit është 31 Dhjetor, 2023.</p> <table border="1" data-bbox="553 1146 1013 1272"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/5/2024</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>65</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2023	Data e publikimit	3/5/2024	Afatet kohore	65		
Periudha referuese	12/31/2023								
Data e publikimit	3/5/2024								
Afatet kohore	65								
<p>14.2. Përpikmëria</p>	<p>Të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve.</p> <table border="1" data-bbox="553 1394 1013 1537"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>3/5/2024</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/5/2024</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2023	Data e shpallur	3/5/2024	Data e publikimit	3/5/2024	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2023								
Data e shpallur	3/5/2024								
Data e publikimit	3/5/2024								
Vonesa në kohë	0								
<p>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</p>									
<p>15.1. Krahasueshmëria gjeografike</p>	<p>Indekset e Çmimeve të Prodhimit grumbullohen dhe llogariten në nivel vendi duke përdorur definicionet sipas rregulloreve evropiane.</p>								

<p>15.2. Krahaseshmëria kohore</p>	<p>Statistikat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit sigurohen me frekuencë tremujore dhe vjetore dhe janë të krahasueshme. Seria kohore për Indeksit e Çmimeve të Prodhimit ekziston nga viti referencë 1999. (Periudha bazë ka ndryshuar: 1999 = 100, 2005 = 100, 2010=100 dhe aktualisht 2020 = 100).</p> <p>Seria kohore për Indeksit e Çmimit në Prodhim disponohen nga viti referencë 2005 (2005= 100) referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 19 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=19).</p> <p>Seria kohore për Indeksit e Çmimeve të Prodhimit Vendas dhe Indeksit e Çmimit të Eksportit disponohen nga viti referencë 2007, referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 17 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=17).</p> <p>Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>
<p>15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave</p>	<p>Indekset janë pjesërisht të krahasueshme me Indeksit e Çmimeve të Konsumit dhe treguesit statistikore të tregtisë së jashtme.</p>
<p>15.4. Koherenca e brendshme</p>	<p>Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre.</p>
<p>16. Kostoja dhe ngarkesa</p>	<p>Personat që punojnë për Anketën e Çmimeve të Prodhimit:</p> <p>Gjithsej: 73 punonjës.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Staf i përgjithshëm në zyrat qendrore: 3 punonjës; • Intervistuesit 52 nga të cilët: 40 anketues afatgjatë dhe 12 afatshkurtër; • Operatorët 9 punonjës; • Kontrollorë 9 punonjës.
<p>17. Rishikimi i të dhënave</p>	
<p>17.1. Politika e rishikimit</p>	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. E njëjta politikë rishikimi zbatohet për të dhënat në nivel kombëtar dhe ato të transmetuara në Eurostat. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit; • Politika e trajtimit të gabimeve.

17.2. Praktika e rishikimit	<p>Të dhënat e publikuara nuk konsiderohen përfundimtare dhe mund të rishikohen. Indekset mund të rishikohen për disa arsye: informacion shtesë, ndryshime metodologjike, ndryshimi i periudhës bazë, korrigjime të gabimeve ose ndryshime metodologjike, por rishikimet janë përgjithësisht mjaft të kufizuara në shkallë.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Indeksin e Çmimeve të Prodhimit” për vitin 2023, subjekt i këtij raporti.</p>
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Burimi i të dhënave për Indeksin e Çmimeve të Prodhimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Anketa tremujore e çmimeve të prodhimit; • Anketa Strukturore pranë ndërmarrjeve ekonomike; • Të dhënat nga dogana.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave kryet me frekuencë 3 mujore, me informacion mujor.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Grumbullimi i të dhënave realizohet nëpërmjet Anketës së Çmimeve të Prodhimit. Mbledhja e rregullt e të dhënave të çmimeve normalisht rrjedh nga një kampion i njësisive statistikore. Plotësimi i informacionit realizohet me intervistim të drejtpërdrejt nga ana e anketuesit me personin e kontaktit të ndërmarrjes, i cili është ngarkuar për të deklaruar të dhënat.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Verifikimi i çmimeve: çmimet e mbledhura krahasohen me trendin e tyre historik, ndryshimet e çmimeve për produkte të ngjashme dhe njohuri të tjera të fituara nga analistët; ndryshimet e konsiderueshme të çmimeve verifikohen me njësinë raportuese. Njësitë raportuese verifikojnë çmimet e produkteve duke raportuar çmimet si për muajin aktual ashtu edhe për atë të mëparshëm dhe nëse ka ndonjë ndryshim, ato ndryshime duhet të shpjegohen në pyetësor. Në INSTAT, çmimet kontrollohen në pyetësor, gjatë procesit të hedhjes së të dhënave dhe me telefon në rastet kur pyetësori nuk është plotësuar si duhet.</p>
18.5. Përpilimi i të dhënave	<p>Hapi i parë është mbledhja e informacionit nga burimet administrative dhe intervista me telefon të ndërmarrjeve. Qëllimi është për të sjellë këtë informacion në nivelin statistikor. Procesi i ndjekur është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli fizik i pyetësorëve; • Kontrolli logjik i informacionit të mbledhur me intervista në

	<p>telefon (kontrolli i shënjitimit logjik të indikatorëve të përgjigjes si dhe kontrolli i plotësimit të shifrave);</p> <ul style="list-style-type: none"> • Procesi i editimit të të dhënave të mbledhura (gabimet dhe modifikimet); • Njësitë që refuzojnë dhe informacioni që mungon duhet të plotësohet përmes procesit të imputimit; • Përdorimi i indekseve të Laspeyres; • Analiza e rezultateve për çdo fushë publike (domein); • Imputimi është metoda statistikore e përdorur për të plotësuar informacionin që mungon në periudhën për të cilën duhet të llogaritet indeksi.
18.6. Rregullimi	<p>Mungesa e çmimeve: Në rastet e mungesës së çmimit të një produkti për imputim përdoret çmimi i muajit të mëparshëm. Zëvendësimi i produkteve që ndërmarrja nuk i prodhon më: Nëse produkti bëhet i padisponueshëm, kryhet zëvendësimi i tij me një produkt, i cili ka karakteristika të ngjashme me të dhe bën pjesë në të njëjtin grup 6 - shifror sipas NP. Zëvendësimi realizohet në bashkëpunim me njësinë statistikore. Për produktin zëvendësues merret informacion për çmimin në periudhën e mëparshme. Rregullimet e cilësisë aplikohen kur vërehen diferenca të çmimit si pasojë e ndryshimit të cilësisë së produktit. Nga njësinë statistikore kërkohet një vlerësim i ndryshimit në cilësinë e produktit. Ky informacion përdoret për aplikimin e metodave të rregullimit cilësor.</p> <p>Produktet e reja: Produktet e reja përfshihen në fund të vitit dhe janë pjesë e kampionit për periudhën pasardhëse.</p> <p>Produktet sezonale: Çmimi i fundit i vrojtuar për produktin sezonal përdoret për llogaritjen e indeksit deri në momentin kur produkti rishfaqet në treg. Të dhënat nuk janë të përshtatura sezonalisht.</p>
19. Komente	
Aneks	